



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës

KONTRATË PËR SHERBIME

KOMUNA E ISTOGUT, ZYRA E PROKURIMIT, të cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z. Zizë Bujupaj, Rruga “Fadil Ferati” në njërën anë; dhe

Egëzon Agushi B.I. - NTP “BLETARIA EGZONI” me NRB 810241183 nga Gjakova, Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson z. Egëzon Agushi në cilësinë e drejtorit të ndermarrjës nga ana tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS

PERKRAHJA E BLETARËVE ME SHOQËRI BLETËSH DHE KOSHERE

Nr. I prokurimit	633 – 020 -3527 -1-2-1 C379
I brendshëm	633-020 / 049 -121 C379

Neni 1 Lënda

1.1 PERKRAHJA E BLETARËVE ME SHOQËRI BLETËSH DHE KOSHERE

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **20.10. 2020** dhe përfundon me **20.11.2020**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **30. ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve dhe shërbimeve do të jetë **KOMUNA E ISTOGUT ”- Respektivisht vendi do të caktohet nga mbikqyrësi i projektit të aktivitetit në fjalë.**

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **35.000,00 €**;
Me shkronja "Tridhjetëepesëmijëeuro"

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Autoriteti Kontraktues do ta paguaj shumën totale te pagesës pas kryerjes së shërbimeve

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të Shërbimeve dhe furnizimeve, Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në vlerë prej 10% është 30. Ditë pas furnizimit dhe shërbimit te aktivitetit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryejë njëën ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judicata; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrim.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore - Departamenti per Çështje Ekonomike.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe dhe Serbisht në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.


**Për Autoritetin Kontraktues
Komuna e Istogut**

**Për Kontraktorin:
"Egëzon Agushi B.I"**

NTP "EGËZONI"

Emri:	<i>Gëzim Ademaj</i>	Emri:	<i>Egëzon Agushi</i>
Pozita:	<i>U. D. Menaxher-it i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>D r e j t o r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	<i>20-10-2020</i>
Vula:		Vula:	

KOMUNA E ISTOGUT					
Perkrahja e bletareve me shoqeri bletesh dhe koshere					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
1					
1.1	Koshere LR-nje(1) katesh	cope	400	23.5 €	9,400.0 €
1.2	Shoqeri Bletesh me 6 korniza	copo	400	64.0 €	25,600.0 €
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					35,000.0 €

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	N.T.P Bletaria "Egzoni"
Adresa e plotë:	Minatori, 50000, Gjakovë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Egëzon Agushi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	05/08/2020
Vula:	



KOMUNA E ISTOGUT					
Perkrahja e bletareve me shoqeri bletesh dhe koshere					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
1					
1.1	Koshere LR-nje(1) katesh	cope	400	23.5 €	9,400.0 €
1.2	Shoqeri Bletesh me 6 korniza	copo	400	64.0 €	25,600.0 €
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					35,000.0 €

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	N.T.P Bletaria "Egzoni"
Adresa e plotë:	Minatori, 50000, Gjakovë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Egëzon Agushi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	05/08/2020
Vula:	

